

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës -PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Ndërtimi i infrastrukturës së aksesimit dhe ankorimit për operimin e asetit gjenerues termik, në portin e peshkimit Triport -Vlorë".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime Ndërtimi- 45210000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 280,000,000 (Dyqind e tetëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor KESH sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Bazuar sa më sipër, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori/et ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar dhe garantuar se Operatorët Ekonomik Pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Në nenin 77, pika 3 e LPP citohet ndër të tjera si më poshtë: 3. "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar

në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore,
 - Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme të deklaruara në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P - 1/A Punime gjurmimi në tokë.
- N.P - 4/A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista Aeroportuale
- N.P - 5/A Punime nentokesore Ura e Vepra Arti
- N.P - 8/E Ndërtime Detare dhe punime thellimi uji
- N.P - 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 6/A Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- N.S - 18/A Punime topogjeodezike
- NS - 20/A Shpime Gjeologjike - Inxhinierike, puse e shpime për ujë

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

Referuar Termave të Referencës si dhe përshkrimit të punës, kategoritë e licencave të kërkuara janë në përputhje me natyrën dhe zërat e punimeve për objektin që prokurohet pasi objekti i prokurimit përfshinë punime mjaft specifike si : (Punime për thellimin e portit si – gjurmim në prezencë të ujit dhe zhvendosje të materialit të ngurtë , Punime për rikonstruksionin e rrugës lidhëse – Mbushje me çakëll, shtresa zhavorri, stabilizant, binderi, asfaltbetoni, ndërtim kanali/kunetë si dhe parashikimet e punimeve kërkuara). Referuar punimeve specifike, bëjnë të domosdoshme kërkesën që operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë, të jenë të pajisur me licencë zbatimi për punime ndërtimi, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e

rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

N.P - 1/A Punime gërmimi në tokë. – Është kërkuar pasi kemi punime gërmimi për pastrime dhe skarifikime për fillimin e punimeve ne hapësirën ku do te ndërtohet rruga e re pasi terreni është i pa rregulluar.

N.P - 4/A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista Aeroportuale – Eshtë kërkuar pasi kërkohet të projektohet dhe ndërtohet rruge e re dhe rehabilitimi i asaj ekzistuese.

N.P - 5/A Punime nentokesore Ura e Vepra Arti. – Eshtë kerkuar pasi është e nevojshme ndërtimi i kanalit prej betoni përgjatë gjithë gjatësisë së rrugës, në të dy anët e saj.

N.P - 8/E Ndërtime Detare dhe punime thellimi uji – Eshtë kërkuar pasi do të kryhen punime me qëllim thellimin e hapsirës portuale në seksionin e kërkuar. Pika E e licensës është kërkuar për shkak se ky zë punimesh përfaqëson volumin dhe vlerën më të madhe të këtij objekti.

N.P - 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit – Eshtë kërkuar pasi punimet e thellimit dhe te transportimit në hapsirën portuale dhe jashte saj, si dhe në zonën tokësore të portit kërkojnë një vlerësim të ndikimit në mjedis.

N.S - 6/A Sinjalistike rrugore jo ndriçuese – Është kërkuar pasi rruga e aksesit ne brendësi te hapësirës tokësore te portit kërkon standarde minimale qe lidhen me sigurinë rrugore te mjeteve te tonazhit te rende te cilat operojnë ne port.

N.S - 18/A Punime topogjeodezike – Është kërkuar pasi punimet e thellimit ne hapësirën detare kërkojnë kontroll te vazhdueshëm batimetrik me qellim arritjen e kuotës se kërkuar te thellimit gjate procesit te punimeve, po ashtu është ne fazën e projektimit.

NS - 20/A Shpime Gjeologo - Inxhinierike, puse e shpime për ujë – Është kërkuar pasi është e nevojshme të kryhet një studim gjeologo-inxhinierik i zonës ku do te ndërtohet rruga e re si dhe rehabilitimi i asaj ekzistuese pasi zona ne fjale është mocalore dhe me probleme te qëndrueshmërisë se bazamentit.

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesin licencë të vlefshme për projektimi ose të kontraktojë me një shoqëri projektuese të licencuar sipas rregullores së miratuar në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”, Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 6.a Projektim rruge lokale , rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore
- 7.a Ura dhe vepra arti të vogla deri në 10m.
- 8.a Rilevime inxhinierike
- 9.d Studim / vlerësim gjeologo- inxhinierik i tojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët
- 9.e Studime e projekte hidrogjeologjike

- 11.a Projektim sinjalistike jondricuese ne rruge lokale , rruge urbane dytesore , rruge interurbane dytesore , sheshe e parkime
- 12.a Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- 12.e Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkrifëta me mundësi lëngëzimi.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Referuar Termave të Referencës si dhe llojit të procedurës së prokurimit (neni 39, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”), kategoritë e kërkuara janë në përputhje me të gjitha detyrimet specifike që projekt zbatimi duhet të përmbajë:

(Raporti mbi investigimin e gjendjes aktuale, identifikimin e problematikave, analizimin e detyrave që kërkohen për zgjidhjen e projektit. Studimi gjeologjik, gjeoteknik dhe hidro-gjeologjik. Rilevimi topografik dhe batimetrik i zonës përreth, profilet gjatësore dhe tërthore. Evidentimin e zonave problematike duke dhënë zgjidhjet e problemeve që shfaqen. Studimi dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis VNM. Relacionet teknike të shoqëruara me llogaritjet përkatëse për të gjitha masat inxhinierike të parashikuara si raportet ndihmëse për topografinë, batimetrinë si dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, etj. Vizatimet teknike për të gjitha elementet infrastrukturore dhe thellimit të basenit që do të zbatohen me profilet tërthore dhe gjatësore sipas kushteve dhe kritereve teknike të projektimit. Specifikimet teknike ku të përcaktohen materialet e ndërtimit që do të përdoren, të dhënat e vetive fiziko-mekanike të tyre, etj. Tabela e sasive metrike (volumet e punimeve) të ndara sipas profileve tërthore të dhëna në vizatimet përkatëse. Preventivin e punimeve. Grafiku i punimeve Metodologjia e zbatimit të punimeve) etj

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 (njëqind) punonjës për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022):

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022).

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa Teknike se Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 (njëqind) punonjës është në përputhje me objektin e prokurimit, rëndësisë së veprës, afatit kohor, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm në rastin konkret të konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Pasi referuar llojit të kontratës e cila përfshin realizimin e projekt zbatimit dhe zbatimin e këtij projekti, kërkon angazhim të stafit projektues dhe zbatues.

Numri prej minimalisht 100 (njëqind) punonjës është gjykuar duke pasur parasysh të gjitha elementet e kësaj vepre, si volumi, natyra, afati i kontratës dhe mundësisë së mobilizimit të punonjësve në orare të caktuara sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Periudha (Maj 2022- Korrik 2022) e kërkuar një periudhë të arsyeshme dhe proporcionale për provimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një stafi të qëndrueshëm i cili është i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Kjo është një kërkesë në përputhje me natyrën e kontratës, volumin dhe përmasat e saj .

2.3.5 Operatorët ekonomik duhet të ketë të punësuar personelin kryesor si Drejtues teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022), stafi inxhinierik si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me eksperiencë pune minimale 15 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me eksperiencë pune minimale 10 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeodet, me eksperiencë pune minimale 15 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeolog, me eksperiencë pune minimale 15 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Hidroteknik me eksperiencë pune minimale 15 vjet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Mjedisi me eksperiencë pune minimale 10 vjet

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë,
- CV,
- Librezë e pune

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Maj 2022- Korrik 2022), stafin mbështetës si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1 (një) inxhinier ndërtimi
- ✚ minimalisht 2 (një) inxhinier hidroteknik,
- ✚ minimalisht 1 (një) Ekspert mjedisi të pajisur me Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”,
- ✚ minimalisht 1(një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,
- ✚ minimalisht 1 (një) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier",
- ✚ minimalisht 1 (një) mjek të përgjithshëm të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë / çertifikatë

Argumentimi për kriteret 2.3.5 dhe 2.3.6 :

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Për sa i takon inxhinierëve të ndërtimit të kërkuar, janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinierët e ndërtimit janë ekspertët kryesor për projektimin dhe zbatimin duke patur parasysh natyrën e investimit që do të kryhet.

- Për sa i takon inxhinierëve hidroteknik të kërkuar, janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinierët hidroteknik do të ndjekin ecurinë e punimeve hidroteknike që nga projektimi deri në zbatimin e plotë të investimit për punimet e thellimit të portit dhe sistemit të kullimit të rrugës.

-Për sa i takon inxhinierit gjeodet të kërkuar, është i nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri gjeodet do të jetë pjesë aktive e procesit të projektimit dhe zbatimit të kontratës duke bërë të mundur matjet dhe rievimet topografike dhe batimetrike të kësaj kontrate specifike.

-Për sa i takon inxhinierit gjeolog të kërkuar, është i nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri gjeolog do të jetë pjesë aktive e procesit të projektimit dhe zbatimit të kontratës duke

bërë të mundur studimin dhe drejtimin e punimeve të lidhura me gjeologjinë e hapësirës detare dhe tokesore ku do të kryhen punimet.

- Për sa i takon inxhinierit të mjedisit të kërkuar, si kriter në mënyrë që Kontraktori të këtë aftësinë e duhur dhe njohuritë e nevojshme për të realizuar punimet e kërkuara si dhe për të evituar pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis, pasi këto punime do të realizohen në një pjesë shumë të rëndësishme dhe kanë ndikim të lartë mjedisor në zonën detare dhe tokesore.

Minimalisht 1 (një) Ekspert mjedisi të pajisur me Certifikatë "Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor":

Ky kriter është vendosur në respekt të nenit 20 pika 4 ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, ku citohet se "Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, raporton për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë."

Operatori ekonomik në cilësinë e zbatuesit të punimeve dhe në respekt të parashikimeve që rrijedhin nga neni 20 pika 4 i ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar dhe aktit nënligjor në zbatim të ligjit duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor në cilësinë e zhvilluesit të punimeve, për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.

Minimalisht 1 (një) punonjës të pajisur me certifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe Minimalisht 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier":

Ky kriter është vendosur në mbështetje të ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Minimalisht 1 (një) mjek të përgjithshëm të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune:

Ky kriter është vendosur në mbështetje të VKM Nr. 692 date 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, date 06.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë".

Natyrë e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatorët ekonomikë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të kenë kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentet përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (Pesë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi drejtimi

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. 5 (Pesë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda, janë kërkuar referuar makinerive të kërkuara, ku drejtimi i tyre duhet të kryhet nga punonjës të kualifikuar.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: 2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";
- c) ISO 45001: 2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" .

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për vetë natyrën e veçantë, vëndndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të

cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me :

- Licensë Kodi III.2.A (1+2) "Ndikimi në mjedis Auditim Mjedisor"
- Licensë Kodi III.2.B "Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave"

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese", si më poshtë:

- Licensat e kërkuara më sipër.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Licencat e mësipërme janë kërkuar në respektim të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar dhe të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 "Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 3.5 -5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me vinxh me kapacitet mbajtës 5-10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës jo më pak se 20 ton	3 copë	Pronësi ose me qera

Kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë Thithese	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozita uji 5000 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Rula vibrues	1 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibratore betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor ajri	1 copë	Pronësi ose me qera
Motosaldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Kulle ndricimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Betoni	1 copë	Pronësi / qera/ Furnizim
Zyre Kantieri	1 copë	Pronësi ose me qera
Drage - Ponton gjermimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Maune vetshkarkuesenë port (Split Barge)	1 copë	Pronësi ose me qera

“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: çertifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse;
Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- c) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

-Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se disponon mjet Maune vetshkarkuese në porte (Split Barge) e regjistruar në regjistrin Detar Shqiptar. Për të cilën duhet të paraqesë Certifikatë të vlefshme regjistrimi në regjistrin Detar Shqiptar dhe foto. Në rast se mjete është marë me qera duhet të paraqesë edhe kontratën e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

- Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se disponon mjet Platformë për realizimin e gërmimit në det (Ponton gërmimi), për të cilin duhet të paraqesë specifikimet teknike dhe fotot përkatëse. Në rast se mjete është marë me qera duhet të paraqesë edhe kontratën e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) është një kompani publike e licënsuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar nga asetet gjeneruese që ka nën administrim.

Modeli aktual i Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar nga ERE, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 620, datë 22 Tetor 2021 për: “Miratimin e kushteve të Detyrimit të Furnizimit Publik (DFP) për të licënsuarit e Sektorit Energjistik Shqiptar, gjatë periudhës së gjëndjes së jashtëzakonshme të furnizimit me energji, për të parandaluar dhe përballuar pasojat e krizës globale të energjisë” e ngarkon KESH sh.a. me detyrimin që të sigurojë të gjithë energjinë e nevojshme për të përmbushur nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU). Për përmbushjen e këtij detyrimi, KESH duhet të përdorë së pari energjinë e prodhuar nga asetet e veta gjeneruese duke e kombinuar me marrëveshje shkëmbimi apo depozitimi, dhe në rast të mosplotësimit të kërkesës së FSHU, të blejë pjesën tjetër në tregun e parregulluar.

Përmbushja e DFP në kushtet e krizës globale energjitike të shoqëruar me ngritjen e menjëhershme të çmimeve të energjisë në tregjet rajonale si dhe varësia e prodhimit të energjisë nga kushtet hidro meteorologjike, e vendos KESH sh.a. në një trysni jo të zakonshme financiare dhe operationale. Qeveria e Shqipërisë u angazhua në mbështetje të KESH sh.a. për përmbushjen e DFP me kosto sa më të ulët, dhe për minimizimin e pasojave të çmimeve të rritura dhe të paparashikueshme të energjisë në tregjet rajonale.

Nëpërmjet VKM Nr. 757, datë 21 Dhjetor 2021, për “Disa ndryshime në VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021”, Qeveria e Shqipërisë autorizon KESH sh.a., që në përputhje me nevojat dhe mundësitë që do të paraqiten, t’i drejtohet tregut ndërkombëtar për të marrë përkohësisht (1-2 vjet) me qera asete gjeneruese termike shtesë, të cilat mund të instalohen dhe lidhen lehtësisht me Rrjetin e Transmetimit të Energjisë në Shqipëri.

Termet e Referencës kanë si qëllim krijimin e infrastrukturës së nevojshme për aksesim dhe operim optimal në zonën portuale detare, si dhe në atë tokësore në brendësi të territorit të Triportit Vlorë.

Argumentim lidhur me Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Neni 45 i Vendimit nr.285, date 19.05.2021 lidhur me kriteret për shpalljen e ofertës fituese përcakton:

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. *Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose
- b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose
- c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Lidhur me Kontratë me çelësa në dore percaktohet ne nenin 39 te Vendimit 285, date 19.05.2021;

Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” percakton:

1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse,

b) me kontratë me çelësa në dorë:

- i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

- ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Njësia e prokurimit